



# Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës

Mbështet, mbron dhe promovon të drejtat dhe interesat e grave dhe vajzave

## **RrGGK dënon dhunën që ndodhi pas përfundimit të protestës mbarëpopullore të 24 janarit**

Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës (RrGGK) dënon dhunën që ndodhi pas përfundimit të protestës mbarëpopullore të organizuar nga shoqata "Thirrjet e Nënave", me 24 janar 2015.

RrGGK poashtu kërkon nga institucionet kompetente që:

1. Të bëhen publik emrat e personave që shkaktuan këto akte dhune;
2. Përgjegjësit të vihen para drejtësisë dhe të marrin dënimin e merituar për aktin e kryer; dhe
3. Të njëjtit persona të obligohen me ligj që të paguajnë dëmet e shkaktuara materiale, në mënyrë që me këto shpenzime të mos ngarkohen taksapaguesit e Kosovës.

*Misioni i Rrjetit i Grupeve të Grave të Kosovës (RRGGK) është të përkrahë, mbrojë dhe promovojë të drejtat dhe interesat e grave dhe vajzave anembanë Kosovës, pa marrë parasysh bindjet e tyre politike, religjionin, moshën, nivelin e arsimimit, orientimin seksual apo aftësitë e kufizuara. RrGGK përmbush misionin e vet përmes këmbimit të përvojave dhe informatave, partneriteteve dhe rrjetëzimit, hulumtimeve, avokimit dhe ofrimit të shërbimeve. Si Rrjet i 88 organizatave të grave nga të gjitha grupet etnike në tërë Kosovën, RrGGK avokon në emër të grave kosovare në nivel lokal, rajonal dhe ndërkombëtar.*

# PRESS

[www.womensnetwork.org](http://www.womensnetwork.org) • Hajdar Dushi St. C-2 II/8, 10000  
Prishtina, Kosovo • +381 (0) 38 245 850 •  
[info@womensnetwork.org](mailto:info@womensnetwork.org)